



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale  
Mbledhja nr. 57  
Prishtinë, më datë 16 shkurt 2010, ora 13:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

**PROCESVERBAL**

**I Mbledhjes së Komisionit të Shëndetësisë, të Punës  
dhe të Mirëqenies Sociale**

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Teuta Hadri, Qamile Morina, Flora Brovina, Mursel Halijli , Nurishahe Hulaj dhe Bujar Bukoshi .

Munguan : Rita Hajzeraj, dhe Gjylnaze Syla,

Të pranishëm: Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit, Shpresa Haxhijaj - administratore , Rrezarta Ahmeti – KDI dhe Nexhat Shatri – zyra e presidentit.

Mbledhjen e kryesoi: Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e dt. 05.02.2010 dhe 09.02.2010 ;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale ;**
- 4. Të ndryshme**

*Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e dt. 05.02.2010 dhe 09.02.2010 ;**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, i Punës dhe i Mirëqenies Sociale i miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me 5 dhe 9 shkurt 2010, me vërejtjen e deputetes Qamile Morina, për plotësimin e diskutimit të saj në mbledhjen e datës 5 shkurt 2010.*

## 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Produkte dhe Pajisje Medicinale ;

**Sadik Idriz** – Nga grupit punues për amendamentimin e P/Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale , që kryesohet nga nënkryetarja Rita Hajzeraj, kemi një propozim për mbajtjen e dëgjimit publik për këtë Projektligj. Dëgjim publik propozohet të jetë me 3 mars 2010, bashkangjitur kemi edhe propozimin për të ftuarit që do të jen: përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë (sponzoruesit e Projektligjit) , përfaqësuesit e Agjencionit Kosovar për Produkte Medicinale, përfaqësuesit e kompanive farmaceutike , Shoqata Farmaceutike e Kosovës, dhe ekspert të fushës përkatëse. Presim edhe propozimet tuaja në mënyrë që në dëgjim publik të jen të ftuat të gjitha grupet e interesuara për këtë ligj.

**Flora Brovina** – Lidhur me vizitën që patëm në kompaninë e produkteve farmaceutike „Kondirolli” propozoj që para dëgjimit publik për P/Ligjin, të vizitojm edhe dy laborator galen që u përmenden edhe gjatë vizitës dhe të njoftohemi më afër me punën e këtyre laboratorëve. Gjithashtu propozoj që lidhur me vizitën që e patëm sot ta parashtrojmë edhe një pyetje parlamentare për ministrin e shëndetësisë në emër të komisionit , në lidhje me vështirsit e punës së kompanisë „ Kondirolli ‘ ‘.

**Sadik Idriz** – Vizitën që e bëmë si komision ishte pjesë e punës sonë dhe ishte mjaft e rëndësishme. Të shtrojmë pyetje për ministrin në emër të komisionit nuk është një procedurë e paraparë me rregulla të Parlamentit . Propozoj që në muajin mars, kur është e paraparë me plan të punës që ministrin e shëndetësisë ta kemi në Komision, ta pyesim edhe për problemet e kompanisë „ Kondirolli’ ‘.

**Teuta Hadri** – Si komision nuk kemi të drejt ti bëjmë pyetje ministrit, por si deputete do ta bëj një pyetje parlamentare për ministrin e shëndetësisë se përse asaj kompanie ju kanë shkaktuar vështërsi në punë.

**Nurishahe Hula**j – Si Komision duhet ta shtyjme këtë çështje përpara , të përgatisim një material faktik për gjendjen, ta procedojmë në kryesin e Kuvendit dhe të kërkojmë debat në Kuvend lidhur me gjendjen e krijuar në sektorin farmaceutik. Problemet janë evidente dhe duhet të ketë zgjidhje, që edhe në Kosovë të ketë prodhim të barnave pasi kemi edhe investime shumë të mëdha që janë bërë për hapjen e kompanive për prodhimin e barnave.

**Flora Brovina** – Pajtohem që të kërkojmë debat në Kuvend me rekomandimet që ne do ti bënim. Nuk është në rregull që me gjithë investimet e bëra në këtë sektor, të mos mund ta zhvillojnë veprimtarin e tyre dhe askush të mos përgjigjet. Kosova ka nevojë për investim dhe duhet tu krijojmë mundësi të punojnë sipas ligjit. Propozoj të formohet një grup punues i cili do të punoj në këtë çështje .

**Sadik Idriz** – Të gjithë jemi të pajtimit se kjo situatë e krijuar me kompaninë „Kondirolli ‘ ‘ nuk është e drejt. Ne do të punojmë që të ngrisim këtë çështje, qoftë me debat në Komision qoftë në Parlament.

**Qamile Morina** – Propozoj që nga kompania „ Kondirolli ‘ ‘ të kërkojmë materialet që i posedon lidhur me kërkesat dhe përgjigjet që i ka bërë në MSH dhe në AKPM, në mënyrë që ne të jemi më të përgatitur për të dhënë rekomandimet tona. Gjithashtu propozoj që të kërkojmë nga AKPM se cilat janë laboratorët galene të licencuara në Kosovë.

*Pas diskutimeve, Komisioni njëzëri vendosi që dëgjimi publik për projektligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale të mbahet të mërkurën me 3 mars 2010 në orën 11:00.*

#### **4. Të ndryshme**

**Sadik Idriz** – Kemi një shkresë nga sekretari i Kuvendit, lidhur me propozimin e një liste të ekspertëve të cilët do ta ndihmojnë punën e Komisionit . Kemi edhe një propozim nga UNDP- ja, për angazhimin e një eksperti , por kemi edhe premtim se për ligjet për punën dhe për ligjin për sigurime shëndetësore do të angazhojnë edhe ekspert ndërkombëtar. Gjithashtu nga anëtarët e Komisionit u kërkua një vizitë studimore, jashtë Kosovës, lidhur me ligjin për sigurime shëndetësore dhe ligjin e punës.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

**Përgatiti:**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Sadik Idriz**